



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr 860 prot.

Tiranë, më 16.06 2023

V E N D I M

Nr.1, datë 31.05.2023

PËR

**“MIRATIMIN E HARTAVE TË RISKUT NGA PËRMBYTJET PËR
TERRITORIN E ZONAVE KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA
PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, DRIN-BUNË
4, 5 DHE 6”**

Në mbështetje të Kreut 2, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e hartave të riskut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për publikimin e hartave në faqen e internetit, për të qënë të disponueshme për publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BEJAN DALLBUKU

